

V E N D I M
Nr.500, datë 13.8.1998

**PËR MBYLLJEN TËRËSORE TË DISA MINIERAVE TË QYMYRGURIT, TË HEKUR-
NIKELIT DHE FABRIKËS SË PASURIMIT TË QYMYRGURIT MALIQ**

Në mbështetje të neneve 2, 12 dhe 13 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me strategji të veçantë", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Mbylljen tërësore të ndërmarrjes minerare të qymyrgurit Alarup, Pogradec dhe të ndërmarrjes minerare të qymyrgurit Bezhan, Kolonjë.

2. Mbylljen tërësore të sektorëve të mëposhtëm:

- sektori Krosnisht i ndërmarrjes minerare të qymyrgurit Gore, Korçë;
- fabrika e pasurimit të qymyrgurit Maliq, Korçë;
- sektori i hekurnikelit Gradisht i ndërmarrjes minerare Guri i Kuq, Pogradec;
- sektori i hekurnikelit Çervenakë i ndërmarrjes minerare Guri i Kuq, Pogradec.

3. Pajisjet e makineritë e sektorëve dhe ndërmarrjeve minerare që mbyllen, të transferohen në ndërmarrje të tjera minerare, që vazhdojnë veprimtarinë e tyre.

Ndërmarrjet dhe sektorët minerarë të mbyllen gjatë vitit 1998. Fondet për mbylljen e tyre janë ato të parashikuara në fondet e miratuara për mbylljen dhe konservimin e minierave në Buxhetin e Shtetit të vitit 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano